



*Liberté • Égalité • Fraternité*

**RÉPUBLIQUE FRANÇAISE**

## DEKLARATË E PËRBASHKËT

E REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË FRANCËS

PËR BASHKËPUNIM

NË LUFTIMIN E RRJETEVE TË PARREGULLTA TË IMIGRIMIT

DHE RRJETEVE TË TRAFIKIMIT ME NJERËZ

Duke pasur parasysh se rrjetet e parregullta të imigrimit dhe rrjetet e trafikimit me njerëz përbëjnë një kërcënim si kohezionit shoqëror kudo që këto aktivitete shfaqen, ashtu edhe për stabilitetin rajonal dhe interesat e Kosovës dhe të partnerëve të saj ndërkombëtar, në veçanti të Francës,

Duke njohur lidhjet që mbahen në mes rrjeteve të parregullta të imigrimit dhe rrjeteve të trafikimit me njerëz në ndjekjen e aktiviteteve kriminale transnacionale të tyre ,

Duke qenë të përkushtuar në mbrojtjen e dinjitetit të viktimave të këtyre rrjeteve dhe në veçanti në mbrojtjen e atyre më të dobhtëve, si gratë dhe fëmijët,

Duke synuar vendosmërisht parandalimin dhe frenimin e aktiviteteve të këtyre rrjeteve, si pjesë e përpjekjeve të tyre të përbashkëta kundër krimit të organizuar dhe në përputhje me rregullat dhe parimet për Sundimin e Ligjit,

Duke kërkuar forcimin e bashkëpunimit të tyre operacional kundër këtyre rrjeteve, në bashkëpunim me EULEX-in (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë),

Të vendosur që ky bashkëpunim do të ndihmon në nxitjen e aspiratave evropiane të Kosovës, posaqërisht në synimin për fillimin e dialogut me Bashkimin Evropian mbi lehtësimin e vizave dhe eventualisht liberalizimit të regjimit të vizave,

Duke përshëndetur nënshkrimin më 2 Dhjetor 2010 të marrëveshjes lidhur me ripranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim:

## **SHITJÇË**

### **INICIATIVAT PËR BASHKËPUNIM POLICOR NË MES TË FRANCËS DHE KOSOVËS**

#### **TË IMPLEMENTUAR MË 2010**

#### **NË FUSHAT QË KANË TË BËJNË ME LUFTËN KUNDËR**

#### **RRJETEVE TË PARREGULLTA TË IMIGRIMIT**

#### **DHE RRJETEVE TË TRAFIKIMIT ME NJERËZ**

#### **1. Misionet në organet policore të Kosovës:**

- Mision i ndërmarrë nga Zyra Qendrore për Luftimin e Imigrimit të Parregulltë dhe Punësimin e të Huajve Pa dokumente e Francës (OCRIEST).
- Misioni i ndërmarr nga Zyra Qendrore për Luftimin e Trafikimit me Njerëz e Francës (OCRTEH).

#### **2. Internshipet brenda OCRIEST dhe OCRTEH:**

- Trajnimi i një zyrtari përgjegjës për luftimin e krimit të organizuar.
- Trajnimi i dy zyrtarëve policorë të Kosovës.

#### **3. Sigurimi i materialit për zbulimin e falsifikimit të dokumenteve.**

#### **Veprimet e mëtejme të planifikuara për vitin 2010 (që nuk përfshihen në financimin e MIINISD):**

- Pjesëmarrja nga Kosovarët në modulën e trajnimit tematik "luftimi i falsifikimit të dokumenteve".
- Mision i trajnimit për policinë e Kosovës për procedurat e kontrollimit të pasaportave biometrike.

1. Me anë të kësaj, Franca dhe Kosova kanë vendosur të bashkërendojnë përpjekjet e tyre për luftimin e rrjeteve të parregullta të imigrimit dhe rrjeteve të trafikimit me njerëz.

2. Për këtë qëllim:

a. Franca dhe Kosova vendosin për zgjerimin e shkëmbimit të informacioneve, personelit dhe ekspertëve ndërmjet shërbimeve të tyre të specializuara, në përputhje me praktikën më të mirë evropiane.

b. Pra, për arritjen e kësaj objektive, Franca dhe Kosova bien dakord të zbatojnë një program bashkëpunimi, që nga viti 2010, me përfshirjen e elementeve në vijim:

- Teknikat për mbledhjen, analizat dhe procesimin ligjor të intelegjencës.
- Mbrojtjen e viktimave.
- Luftimin e falsifikimit të dokumenteve.

Një plan i këtyre iniciativave, i financuar më 2010 nga Ministria e Imigrimit, Integrimit, Identitetit Kombëtar dhe Zhvillimit të Solidaritetit të Qeverisë së Republikës së Francës, është i bashkangjitur.

Implementimi i këtyre iniciativave, për Francën, bëhet përmes Drejtorisë Qendrore të Policisë Kufitare, Zyrës Qendrore për Luftimin e Imigrimit të Parregullt dhe Punësimi i të Huajve Pa dokumente dhe Zyrës Qendrore për Luftimin e Trafikimit me Njerëz, nën koordinimin e Departamentit për Bashkëpunim Policor Teknik Ndërkombëtar .

I nënshkruar në Prishtinë, në ditën e dytë të Dhjetorit, 2009.

Për Republikën e Kosovës

Për Republikën e Francës

ZENUN PALAZITI

Eric BESSON

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Imigrimit, Integrimit, Identitetit  
Kombëtar dhe Zhvillimit të Solidaritetit